



Pranuar me: 10.06.2022			
N. org	Numer	Shtojca	Vlera
03	3546	3	✓

## RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti

I Filologjisë

Lëndët

Gjuhë angleze 3, Gjuhë angleze 4  
Anglishtja për qëllime akademike 1 dhe  
Anglishtja për qëllime akademike 2

Kandidatët e paraqitur

1. Albina Hoti  
2. Eglontine Bilalli  
3. Rina Krasniqi  
4. Shpresa Veseli Dragobuzhda  
5. Xhevdet Rusinovci

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Lindita Tahiri  
Prof. Ass. Dr. Blerta Mustafa  
Prof. Ass. Dr. Lendita Kryeziu





UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

**Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"**

**Fakulteti i Filologjisë**

**Për: Këshillin e Fakultetit të Filologjisë**

**CC: Prof.asoc. dr. Lindita Rugova, Dekane e Fakultetit**

Lënda: Raport dhe propozime të komisionit për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime për vitin akademik 2022/23

Komisioni në përbërje: 1. Prof.asoc.dr. Lindita Tahiri (kryesues), 2.Prof.Ass.Dr. Blerta Mustafa dhe 3. Prof.Ass.Dr. Lendita Kryeziu, me Vendimin nr. Prot:01/3459, të datës 14.06.2022, pasi shqyrtoj dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkursin me nr, prot: 1/217, të datës 01.06.2022,shpallur nga UP-ja në uebfaqen zyrtare, si dhe duke u mbështetur në dispozitat Statutit të UP-së,

**Propozon**

Që për vitin akademik 2022/23, të angazhohet:

lektore në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

Në vijim e gjeni RAPORTIN e detajuar lidhur me të dhënat e kandidatëve të propozuar dhe vendimet e komisionit:

**Propozohet:**



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

**MA Rina Krasniqi** (lindur më: 23.06.1995) ka konkuruar për pozitën numër 20 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 8.85. Ajo gjithashtu i ka përfunduar studimet Master në Gjuhësi Aplikative me TESOL ne Universitetin e Sheffield-it, me kampus ne Selanik të Greqisë, me notën mesatare 8.55. Ka të regjistruara poashtu studimet e doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturës dhe Komunikimit. Ka përvojë pune gjashtë vjeçare, prej të cilave katër në mësimdhënie. Vlen të ceket se kandidatja i ka mbajtur ushtrimet për lëndët Gjuhë angleze 3 dhe 4, si dhe ushtrimet në lëndët Gramatika 1 dhe 2 në Departament të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës gjatë vitit akademik 2021/2022. Gjatë kësaj kohe, kandidatja ka treguar performancë të jashtëzakonshme në mësimdhënie. Ka treguar zell e përkushtim në punën e saj me studentë por edhe në raport me stafin akademik e administrativ. Ajo ka shprehur gatishmëri për të ndihmuar në çdo formë të mundshme që puna në Departament të ecë si duhet. Për ta ilustruar këtë, duhet të ceket se gjatë semestrit veror, kandidatja në fjalë ka mbajtur orë shtesë pa asnjë kompenzim financiar vetëm e vetëm që studentët të mos i humbin orët e parapara me asistenten që në fillim të semestrit doli në pushim të lehonisë. Gjithashtu, kandidatja ka treguar aftësi të shkëlqyeshme organizative në administrimin, përpilimin dhe kontrollimin e provimeve por edhe përpikshmëri e profesionalizëm në mbajtjen e konsultimeve. Ka shprehur vullnet e gatishmëri ta ndihmoj stafin në administrim të provimeve edhe në lëndët e tjera si dhe ka marrë pjesë aktive në çdo aktivitet të organizuar nga Departamenti siç është për shembull konferenca vjetore e studentëve apo ekspozita e punimeve hulumtuese të studentëve.

Ajo është trajnere për mësimdhënie të gjuhës angleze e certifikuar nga Shoqata e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze (KETNET) si dhe menaxhere në zhvillimin e kurseve trajnuese në PECB. Ka prezantuar në tetë konferenca vendore, regjionale e ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies. I ka të përfunduara pesë programe trajnuese ndërkombëtare të ofruara përmes Departamentit të Shteteve të Bashkuara të-Amerikës në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Iowa-së, Universitetin Xhorxh Mason dhe World Learning-SIT Graduate Institute, njëri prej të cilëve në mësimdhënien e shkrimit akademik. Gjithashtu i ka të përfunduara edhe disa trajnimeve vendore të ofruara nga KETNET si Trajnimi për Trajner apo edhe trajnimin për përgaditjen e studentëve për testin e standardizuar të TOEFL.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Duke e marrë parasysh përgatitjen adekuate akademike, performancën e jashtëzakonshme në mësimdhënie, ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të saja përmes trajnimeve të shumta kombëtare e ndërkombëtare, Komisioni e propozon, MA. Rina Krasniqi-n për angazhim në pozitën lektore i angazhuar për lëndët: Gjuhës angleze 3, Gjuhës angleze 4, Anglishtja për qëllime akademike 1 dhe Anglishtja për qëllime akademike 2

**Refuzohen:**

**MA.Albina Hoti** (lindur më: 20.04. 1993) ka konkuruar për pozitën numër 20 të konkursit publik të datës.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 8.84. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament-Drjetimi Letërsi, më notën mesatare 8.55 si dhe i ka të regjistruara studimet e doktoratës në po të njëjtën fushë. Në bazë të dëshmive të ofruara, kandidatja ka përvijë 1.5 vjeçare si asistente për ushtrime në lëndët Gjuhë angleze 1 dhe 2 në Fakultet të Inxhinierisë Mekanike në Universitet të Prishtinës, lëndë që u ofrohen studentëve që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj e jo atyre që e kanë fushë të studimit siç e kërkon pozita në fjalë. Kandidatja ka ndjekur dhe prezentuar në tri konferenca të KETNET-it, e ka të përfunduar një trajnim për TOEFL dhe SAT, si dhe ka përvijë në mësimdhënie përmes ofrimit të kurseve të gjuhës angleze (ndonëse ofron dëshmi për një përvijë një vjeçare). Duke marrë parasysh që kandidatja është e profilizuar në fushën e letërsisë angleze e jo gjuhësisë dhe ka numër shumë më të vogël të programeve të zhvillimit profesional në krahasim me kandidaten e propozuar, ajo **nuk propozohet** për pozitën në të cilën konkuron.

**Dr Sc Eglantina Bilalli** (lindur më: 04.04.1991) ka konkuruar për pozitën numër 20 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor (me notën mesatare 8.66.), MA (me notën mesatare 9.13) dhe ato të Doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore. Kandidatja ka ofruar dëshmi edhe për ndjekjen e disa konferencave: një konferencë ndërkombëtare dhe dy regjionale. Gjithashtu ka ndjekur një trajnim vendor që lidhet me mësimdhënien në shkollën e mesme profesionale. Edhe pse kandidatja ka përvijë 10-vjeçare në fushën e mësimdhënies



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

në arsimin parauniversitar dhe universitar, sipas dokumenteve të ofruara kandidatja është e punësuar me kontratë të plotë në UBT, me vlefshmëri të kontratës deri me 30.09.2023 dhe ka angazhim të pjesshëm në shkollën e mesme të artit pamor "Adem Kastrati", që bie ndesh me pikën 9 të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021, ku ceket se në Universitet të Prishtinës "nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare". Gjithashtu, në dokumentet e paraqitura mungon noterizimi i nostrifikimit të diplomave të të gjitha niveleve. Poashtu, kandidatja ka numër shumë më të vogël të trajnimeve e konferencave se kandidatja që propozohet. Duke u bazuar në kriterin e rregullores së lartpërmendur, kandidatja në fjalë **nuk propozohet** për pozitën në të cilën konkuron.

**MA. Shpresa Veseli Dragobuzhda** (lindur më: 08.10.1992) ka konkuruar për pozitën numër 20 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 9.10. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament me notën mesatare 8.55 si dhe i ka të regjistruara studimet e doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturës dhe Komunikimit-programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Edhe pse kandidatja ka përvojë shtatë vjeçare në mësimdhënie në arsimin parauniversitar, ajo **nuk propozohet** për lektor të angazhuar sepse nuk ka përvojë të mësimdhënies në arsimin e lartë, në fushën përkatëse, e gjithashtu nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ndjekje të trajnimeve apo konferencave siç është rasti me kandidaten e propozuar.

**Dr.Sc. Xhevdet Rusinovci** (lindur më: 28.11.1979) ka konkuruar për pozitën numër 20 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidati i ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 6.67. Ai gjithashtu i ka përfunduar studimet Master në të njëjtin Departament me notën mesatare 8.00 dhe ato të doktoratës në Universitetin e Grazit, Austri. Edhe pse kandidati në fjalë ka përvojë gati 18 vjeçare në mësimdhënie, përfshirë këtu edhe mësimdhënien në kolegje dhe Universitet të Prizrenit si dhe ka



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

ndjekur apo edhe prezentuar ne disa konferenca ndërkombëtare, **nuk propozohet** për lektor të angazhuar sepse bie ndesh me pikën 3.2 të nenit 7 të Rregullores Nr.Prot: 1/95 të datës 24/06/2021 ku kërkohet që kandidatët e përzgjedhur për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm të kenë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dyja nivelet e studimit. Gjithashtu, kandidati në fjalë është mbi moshën 40 vjeçare që bie ndesh me pikën 3.3. të nenit 7 të Rregullores në fjalë.

Komisioni vlerësues

6. Kryetar
7. Anëtar
8. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Lindita Tahiri

Prof.Ass.Dr. Blerta Mustafa

Prof.Ass.Dr Lendita Kryeziu